

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.301/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 04.02.2025, merr këtë:

V E N D I M

I. PRANOHEN të bazuara ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.301/2025, të datës 01.02.2025, Anr.308, Anr.309, Anr.310 Anr.315/2025, Anr.321/2025, të datës 02.02.2025.

II. Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 16,000.00€ (gjashtëmbëdhjetë mijë euro).

III. Detyrohet Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datën 01.02.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesën e identifikuar me numër Anr.301/2025,, dhe me datën 02.02.2025 ankesat Anr.308, Anr.309, Anr.310 Anr.315/2025, dhe Anr.317/2025, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

-Në ankesë Anr.301/2025 pretendohet se me 1 shkurt 2025, mbështetësi i subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës - PDK, Rasim Brahim Rexhepi, ka postuar në Ilogarinë e tij në rrjetin social Facebook një tekst i cili përmban gjuhë urrejtëse dhe ofenduese si dhe bie në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë. Teksti i plotë dhe origjinal në Ilogarinë personale të Rasim Brahim Rexhepi në rrjetin social Facebook, është si në vijim: "*Mos të harrojm se kjo qeveri në krye më Albin*

Serbin e ky pushtet na pat detyru me dal ne rrug me ja ndalu veprimet idoteske qe i bente kunder vlerave te luftes, e vjedhjeve masive qe i bente kur erdh ne pushtet, e per kte arsye kena me e rrexu BASHKOHUNI TE GJITHË PER NDER TE ATDHEUT!"

PROVË: Postimi në rrjetin social

-Në ankesën 308/2025, pretendohet se me 2 Shkurt 2025, aktivistë të Lëvizjes VETËVENDOSJE kanë identifikuar mbështetësin e PDK-së Nehat Bunjaku i cili në kuadër të postimeve të shumta të tij ofenduese dhe nxitëse për urrejtje kundrejt LVV-së dhe Kryeministrit Albin Kurti, në llogarinë e tij në facebook poashtu ka shpërndarë fotografinë dhe videon me tekstin mbi fotografi/video "*Herio i Albin Kurti dhe Vetevendosjes Oliver Ivanovi*", më një fotografi përçmuese (*Kurti dhe Ivanovic të përçafuar*), duke nxitur urrejtje dhe duke fyer e ofenduar mes tjerash.

Përmes këtij veprimi mbështetësit/ simpatizantët e partisë politike PDK dhe subjekti politik PDK kanë shkelur rëndë dispozitat e nenit 34. paragrafi 1, pika 1.11 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë. Se Nehat Bunjaku është mbështetës dhe simpatizant i PDK-së, kjo mund të vërehet në provat bashkëngjitur. PROVË: Fotografi dhe link, mes tjerash, ku dëshmohet përdorimi i gjuhës që nxitë, provokon akt të dhunës apo urrejtjes, në kundërshtim me LZP-në, si dhe në të cilën faktohet si mbështetës i PDK-së: https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=2556936647829683&id=100005401188326

-Në ankesën Anr.309/2025 pretendohet se më 1 Shkurt 2025, Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE në Skenderaj ka identifikuar mbështetësin e PDK-së Demë Berisha i cili përmes fotografisë dhe tekstit të shpërndarë në llogarinë e tij në facebook, ka ofenduar rëndë, ka nxitur gjuhë të urrejtjes ndaj Kryeministrit Kurti, njëkohësiht kandidat i LVV për deputet dhe Kryeministër. Në tekstin e shpërndarë, mbështetësi i PDK shkruan "*O servila e Ilaskuca te vegles serbe Kurtoviqit, Sado që paguheni shtrenjtë, perderisa shiteni, nuk keni asnjë vlere.*" Provë: Fotografi dhe link, mes tjerash, ku dëshmohet përdorimi i gjuhës që nxit, provokon akt të dhunës apo urrejtjes, në kundërshtim me LZP-në: <https://www.facebook.com/watch/?v=9632869613390764>

-Në ankesën Anr.310/2025, pretendohet se me datë 2 Shkurt 2025/ Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE në Skenderaj ka identifikuar mbështetësin e PDK-së Enver Rubovci i cili në kuadër të posteve të shumta të tij ofenduese dhe nxitëse për urrejtje kundrejt LVV-së/ në llogarinë e tij në facebook poashtu ka shpërndarë fotografinë dhe videon me tekstin mbi një fotografi/video "*Tradhtia dhe Hajnia kanë Emër.. VETËVENDOSJE bashkë me Albin Kurtin*". Video e tillë poashtu ka takstin "*LVV-ja është strofull e bashkëpunëtorëve të Serbisë!*" Se Enver Rubovci është mbështetës dhe simpatizant i PDK-së, kjo mund të vërehet në provat bashkëngjitur.

Provë: Fotografi dhe link, mes tjerash, ku dëshmohet përdorimi i gjuhës që nxitë, provokon akt të dhunës apo urrejtjes, në kundërshtim me LZP-në, si dhe në të cilën faktohet si mbështetës i PDK-së:

https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=3537170856575287&id=100008472212765

Në ankesën Anr.315/2025, pretendohet se më datë Më 2 Shkurt 2025, Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE në Skenderaj ka identifikuar mbështetësin e PDK-së Muhamet Shala i cili më kuadër të posteve të shumta të tij ofenduese dhe nxitëse për urrejtje, në llogarinë e tij në facebook poashtu ka shpërndarë fotografinë dhe videon me tekstin mbi në fotografi/video "Hajnia ka Emër", njëkohësisht me fotografinë e Kryeministrit Albin Kurti, kandidat për Kryeministër në këto zgjedhje si dhe atë të kandidatëve për deputetë nga radhët e LVV, znj Fitore Pacolli si dhe z. Faton Peci. Se Muhamet Shala është mbështetës dhe simpatizant i PDK-së, kjo mund të vërehet në provat bashkëngjitur. Provë: Fotografi dhe link, mes tjerash, ku dëshmohet përdorimi i gjuhës që nxitë, provokon akt të dhunës apo urrejtjes , në kundërshtim me LZP-në, si dhe në të cilën faktohet si mbështetës i PDK-së: <https://www.facebook.com/muhamet.shala.7165/posts/3859661207589104>

-Në ankesën 321/2025, parashtruesi i ankesës pretendon se me datë 02 shkurt 2025, aktivistë të Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Prishtinë, gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore në rrjetet sociale, ka hasur në përkrahësin e PDK-së, Xh.Morina, që vërtetohet nga prova e bashkëngjitur në tubimin e mbajtur në Malishevë, nga Partia Demokratike e Kosovës, duke shqyer dhe keqpërdorur fotot e kandidatëve tanë: znj. Fitore Pacolli dhe znj. Fjolla Ujkani me çka konsiderojmë se ka nxitur urrejtje ndaj subjekteve në fjalë dhe Lëvizjes VETËVENDOSJE!. Përkundër se video ka marre gjiron e rrjetit social TikTok dhe është shikuar qindra mijëra herë nga përdoruesit, ende PDK nuk është distancuar nga një sjellje e tillë çka e bën edhe më serioze situatën, ku tërthorazi përkrahet kjo sjellje e cila cenon rëndë nenin 34 par 1 nën par 1.11 e cila sanksionon sjelljen nxitëse, provokuese.

Si dëshmi ka bashkëngjitur provë: CD

Përmes këtij veprimi mbështetësit/ simpatizantët e partisë politike PDK dhe subjekti politik PDK kanë shkelur dispozitat e nenit 34. paragrafi 1, pika 1.11 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë.

Në përgjigjen në ankesa të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës theksohet se, para se të trajtojmë meritat e ankesës, e shohim si të rëndësishme për të shqyrtuar çështjen e afatshmërisë së ankesës, pasi që siç mund të vërehet, ankuesi nuk i ka bashkëngjitur si dëshmi asnjë provë me të cilën argumentohet koha në të cilën ka ndodhur shkelja e pretenduar, pasi që në vështrim të provës së bashkëngjitur, dëshmohet vetëm që postimi të jetë shpërndara para disa orësh, mirëpo nuk mund të vërtetohet koha se kur është bërë Screenshoot, andaj si i tillë është e pamundur që të vërtetohet se në cilën kohë ka ndodhur shkelja e pretenduar në ankesë. Gjithsesi, edhe po të konsiderohet i mirëqenë fakti që ankuesi ka parashtruar ankesën në afat, vlerësojmë se ankesat si të tilla janë të pabazuara për arsyet si në vijim: PDK në asnjë mënyrë nuk e konteston faktin se veprimet e personave të cilët janë objekt i kësaj ankese përbëjnë përdorim të gjuhës që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë, për të cilat vlerësojmë se padyshim përbëjnë veprime të ndaluara. Mirëpo, konsiderojmë se ankuesi nuk ka arritur që të argumentoi përgjegjësinë subjektive ndaj

subiektit politik PDK, pasi që siç do të vërej ankuesi me asnië provë nuk ka arritur që të bëj ndërlidhjen e veprimeve të personave të përmendur në ankesë, me përgjegjësinë e subjektit politik PDK, mirëpo është mjaftuar vetëm me pretendimin se të njëjtit janë mbështetës dhe aktivistë të PDK-së. respektivisht nuk ka argumentuar që të njëjtit të jenë pjesë e strukturave të Partisë Demokratike të Kosovës, apo ndonjë lidhje afërsie me këtë subjekt politik.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ankesat e evidentuara me numrat si ne vijim: Anr.301/2025, të datës 01.02.2025, Anr.308, Anr.309, Anr.310 Anr.315/2025, Anr.321/2025, dhe 02.02.2025., janë bashkuar dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.301/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga subjekti i njëjtë politik LVV kundër subjektit të njëjtë politik PDK, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesat gjeti se:

Ankesat janë të bazuara

Paneli, pas shikimit të shkresave të lëndës të ofruara si provë materiale, ka gjetur se mbështetësit dhe simpatizant të subjektit politik PDK, në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, Mbështetesi Rasim Brahim Rexhepi, ka postuar në llogarinë e tij në rrjetin social Facebook një tekst i cili përmban gjuhë urrejtëse dhe ofenduese *"Mos të harrojm se kjo qeveri në krye më Albin Serbin e ky pushtet na pat detyru më dal në rrug më ja ndalu veprimët idoteske që i bënte kunder vlerave të luftës, e vjedhjeve masive që i bënte kur erdh në pushtet, e për këtë arsye kena me e rrëxu BASHKOHUNI TË GJITHË PER NDER TË ATDHEUT!"*. Mbështetësi i PDK-së Nehat Bunjaku i cili në kuadër të postimeve të shumta të tij ofenduese dhe nxitëse për urrejtje kundrejt LVV-së dhe Kryeministrit Albin Kurti, në llogarinë e tij në facebook ka shpërndarë fotografinë dhe videon me tekstin mbi fotografi/video *"Herio i Albin Kurti dhe Vetevendosjes Oliver Ivanovi"*, më një fotografi përçmuese (*Kurti dhe Ivanovic të përçafuar*), Mbështetesi Demë Berisha i cili përmes fotografisë dhe tekstit të shpërndarë në llogarinë e tij në facebook, ka ofenduar rëndë, ka nxitur gjuhë të urrejtjes ndaj Kryeministrit Kurti, njëkohësisht kandidat i LVV për deputet dhe Kryeministër, ku në tekstin e shpërndarë, shkruan *"O servila e Ilaskuca te vegles serbe Kurtoviqit, Sado që paguheni shtrenjtë, perderisa shiteni, nuk keni asnjë vlere."* Mbështetësin e PDK-së Enver Rubovci në llogarinë e tij në facebook poashtu ka shpërndarë fotografinë dhe videon me tekstin mbi në fotografi/video *"Tradhtia dhe Hajnia kanë Emër.. VETEVENDOSJE bashkë me Albin Kurtin"*, ndersa video poashtu ka tekstin *"LVV-ja është strofull e bashkëpunëtorëve të Serbisë!"*. Mbështetësi i PDK-së Muhamet Shala në llogarinë e tij në facebook ka shpërndarë fotografinë dhe videon me tekstin mbi në fotografi/video *"Hajnia ka Emër"*, njëkohësisht me fotografinë e Kryeministrit Albin Kurti, kandidat për Kryeministër në këto zgjedhje si dhe atë të kandidatëve për deputetë nga radhët e LVV, znj Fitore Pacolli si dhe z. Faton Peci. Mbështetësi i PDK-së, Xh.Morina, që vërtetohet nga prova e bashkangjitur në tubimin e mbajtur në Malishevë, nga Partia Demokratike e

Kosovës, duke shqyer dhe keqpërdorur fotot e kandidatëve të LVV-se Fitore Pacolli dhe Fjolla Ujkani.

Paneli vlerëson se gjuha e përdorur si më lartë nga mbështetësit dhe simpatizuesit e PDK-së është gjuhë denigruese dhe urrejtëse në raport me subjektin politik LVV dhe se përdorimi i një gjuhe të tillë është në kundërshtim me nenin 34 pika 1.11), e LZP-së, me të cilën përcaktohet: *“Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: ... 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”*.

Sipas Panelit përmbajtja e deklarimeve të tilla të konsiderohen gjuhë nxitëse dhe urrejtëse kundrejt subjektit politik LVV, dhe se kjo konsiderohet shkelje e rregullave zgjedhore në Kosovë, nga se deklaratimet e tilla në kohë të fushatës zgjedhore, kanë për qëllim të krijojnë polarizim të elektoratit, të krijojnë atmosferë tensioni ose të nxisë ndjenja të urrejtjes dhe të përçarjes, të acaroj rivalitetin politik. Paneli vlerëson se partitë dhe kandidatët si dhe mbështetësit dhe simpatizuesit e tyre janë të detyruar të respektojnë etikën zgjedhore dhe të shmangin veprime apo deklaratime që mund të sjellin pasiguri, destabilitet apo të përkeqësojnë atmosferën politike në përgjithësi, njëkohësisht janë të obliguar të respektojnë dinjitetin dhe integritetin e të tjerëve. Përdorimi i gjuhës së tillë mund të dëmtojë procesin demokratik dhe të rrisë tensionet në vend. Kjo është një shkelje e rregullave që kërkojnë një fushatë paqësore, të ndershme dhe të drejtpërdrejtë.

Andaj Paneli gjeti se gjuha e përdorur është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjegjësisht me dispozitat e nenit 34 LZP-së, ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike dhe me këto veprime janë shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të LZP-së.

Sipas Panelit vendosja përdorimi i kësaj gjuhe nga simpatizantët e subjektit politik të PDK-së, në kuadër të fushatës zgjedhore, konsiderohet shkelje e rregullave zgjedhore në Kosovë, ngase veprimet e marra në kohë të fushatës zgjedhore kanë për qëllim të krijojnë një lidhje negative ose të nxisë ndjenja të urrejtjes dhe krijoj atmosferë tensioni dhe përçarjeje. Veprimet i tilla interpretohen si një përpjekje për të manipuluar perceptimin e votuesve, duke përdorur gjuhë fyese, denigruese dhe përçmuese kundër subjektit politik ankues dhe udhëheqësit të saj, dhe se ky veprim shihet si një mënyrë për të përdorur kualifikime të rënda për të stigmatizuar një subjekt politik dhe për të rritur ndjenjat negative kundrejt subjekti ankues. Paneli vlerëson se partitë politike, kandidatët dhe simpatizantët e tyre janë të detyruar të respektojnë etikën zgjedhore dhe të shmangin veprime që mund të sjellin pasiguri apo të përkeqësojnë atmosferën politike. Përdorimi i figurave të tilla të përfolura mund të dëmtojë procesin demokratik dhe të rrisë tensionet në vend. Kjo është një shkelje e rregullave që kërkojnë një fushatë paqësore, të ndershme dhe të drejtpërdrejtë.

Përdorimi i një gjuhe të tillë, sipas vlerësimit të Panelit është në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 1 pika 1.11), e LZP-së, me të cilën përcaktohet *“Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: ... 1) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund*

të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimet e tilla përbëjnë përsëritje të shkeljeve për nga natyra, pjesëmarrjen e subjektit në fjalë në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se subjekti politik PDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore, e poashtu edhe faktin se shkelja është bërë nga ana e simpatizuesve të subjektit politik në këtë rast PDK, e jo nga ana e kandidatëve apo zyrtarëve të saj.

Duke pas parasysh se Rregullorja 01/2024. dhe dispozitat e LZP, neni 120 paragrafi 1 nën paragraf 1.3 për shkelje të tilla parashohin dënimin me gjobe deri në 50.000 euro, Paneli me rastin e shqiptimit të gjobës ka pasur parasysh edhe praktikën e mëhershme për rastet të ngjashme si dhe faktin që subjekti politikë në fjalë ka bërë shkelje të natyrës së njëjtë në mënyrë të përsëritur.


Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11), neni 118 paragraf 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.301/2025 më datën 04.02.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.38/2025

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Beshir Islami, Franciska Zhitija Ymeri dhe Lumni Sallauka, anëtarë, lidhur me ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), A.nr.301 /2025, të datës 04.02.2025, në seancën e mbajtur me datë, 07.02.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Subjektit Politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, Anr.301 /2025, të datës 04.02.2025.

A r s y e t i m i

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa A.nr. .nr.301 /2025, të datës 04.02.2025, është vendosur "I. Pranohen të bazuara ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.301/2025, të datës 01.02.2025, Anr.308, Anr.309, Anr.310 Anr.315/2025, Anr.321/2025, të datës 02.02.2025. II. Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 16,000.00€ (gjashtëmbëdhjetë mijë euro). III. Detyrohet Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi".

Kundër vendimit të lartpërmendur, Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, në afat të lejuar ligjor ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën



e konteston ligjshmërinë e tij, duke mos i specifikuar shkaqet e ankesës, ndërsa si pretendim kryesor ankimor i saj konstatimi i gabuar i gjendjes faktike, shpërfilljes së standardeve të PZAP-së duke propozuar Gjykatës Supreme të Kosovës, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar të anulohet vendimin A.nr.301/2025, i datës 04 shkurt 2025, i nxjerrë nga PZAP dhe të refuzohen si të pabazuara ankesat e ankuesit Lëvizja Vetëvendosje.

PZAP në përgjigje në ankesën e paraqitur të subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore dhe propozoi që ankesa e Subjektit Politik, PDK, me këtë vendim, të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi A.nr. .nr.301 /2025, të datës 04.02.2025.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datën 01.02.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesën e identifikuar me numër Anr.301/2025, dhe më datën 02.02.2025 ankesat Anr.308, Anr.309, Anr.310/2025, Anr.315/2025, dhe Anr.317/2025, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

Në ankesë Anr.301/2025 pretendohet se më 01.02.2025, mbështetësi i subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës - PDK, Rasim Brahim Rexhepi, ka postuar në llogarinë e tij në rrjetin social Facebook një tekst i cili përmban gjuhë urrejtëse dhe ofenduese me përmbajtje "Mos të harrojmë se kjo qeveri në krye me Albin Serbin e ky pushtet na pat detyrua më dal në rrugë më ja ndalu veprimet idoteske që i bënte kundër vlerave të luftës, e vjedhjeve masive që i bënte kurrdh në pushtet, e për këtë arsye kena me e rrezua bashkohuni të gjithë për nder të atdheut".

Në ankesën 308/2025, pretendohet se më 02.02.2025, aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje kanë identifikuar mbështetësin e PDK-së Nehat Bunjaku i cili në kuadër të postimeve të shumta të tij ofenduese dhe nxitëse për urrejtje kundrejt LVV-së dhe Kryeministrit Albin Kurti, në llogarinë e tij në facebook po ashtu ka shpërndarë fotografinë dhe videon me tekstin mbi fotografi/video "Herio i Albin Kurti dhe Vetevendosjes Oliver Ivanoviqit ", me një fotografi përçmuese (Kurti dhe Ivanovic të përçafuar), duke nxitur urrejtje dhe duke fyer e ofenduar. Përmes këtij veprimi mbështetësit/ simpatizantët e partisë politike PDK



dhe subjekti politik PDK kanë shkelur rëndë dispozitat e nenit 34. paragrafi 1, pika 1.11 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë.

Në ankesën Anr,309/2025 pretendohet se më 1 Shkurt 2025, Qendra e Lëvizjes Vetëvendosje në Skenderaj ka identifikuar mbështetësin e PDK-së Demë Berisha i cili përmes fotografisë dhe tekstit të shpërndarë në Ilogarinë e tij në facebook, ka ofenduar rëndë, ka nxitur gjuhë të urrejtjes ndaj Kryeministrit Kurti, njëkohësisht kandidat i LVV për deputet dhe Kryeministër. Në tekstin shpërndarë, mbështetësi i PDK shkruan " O servila e Ilaskuca të veglës serbe Kurtoviqit, Sado që paguheni shtrenjtë, perderisa shiteni, nuk keni asnjë vlere."

Në ankesën Anr.310/2025, pretendohet se më datë 02.02.2025, Qendra e Lëvizjes Vetëvendosje në Skenderaj, ka identifikuar mbështetësin e PDK-së, Enver Rubovci i cili në kuadër të posteve të shumta të tij ofenduese dhe nxitëse për urrejtje kundrejt LVV-së/ në Ilogarinë e tij në facebook po ashtu ka shpërndarë fotografinë dhe videon me tekstin mbi në fotografi/video "Tradhtia dhe Hajnia kanë Emër VETEVENDOSJE bashkë me Albin Kurtin". Video e tillë po ashtu ka tekstin "LVV- ja është strofull e bashkëpunëtorëve të Serbisë". Se Enver Rubovci është mbështetës dhe simpatizant i PDK-së, kjo mund të vërehet në provat bashkëgjatur.

Në ankesën Anr.315/2025, pretendohet se më datë më datë2 Shkurt 2025, Qendra e Lëvizjes Vetëvendosje në Skenderaj ka identifikuar mbështetësin e PDK-së Muhamet Shala i cili në kuadër të posteve të shumta të tij ofenduese dhe nxitëse për urrejtje, në Ilogarinë e tij në facebook poashtu ka shpërndarë fotografinë dhe videon me tekstin mbi në fotografi/video "Hajnia ka Emër", njëkohësisht me fotografinë e Kryeministrit Albin Kurti, kandidat për Kryeministër në këto zgjedhje si dhe atë të kandidatëve për deputetë nga radhët e LVV, znj Fitore Pacolli si dhe z. Faton Peci. Se Muhamet Shala është mbështetës dhe simpatizant i PDK-së, kjo mund të vërehet në provat bashkëgjatur. Provë: Fotografi dhe link, mes tjerash, ku dëshmohet përdorimi i gjuhës që nxitë, provokon akt të dhunës apo urrejtjes, në kundërshtim me LZP-në.

Në ankesën 321/2025, parashtruesi i ankesës pretendon se më datë 02 shkurt 2025, aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë, gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore në rrjetet sociale, ka hasur në përkrahësin e PDK-së, Xh.Morina, që vërtetohet nga prova e bashkëgjatur në tubimin e mbajtur në Malishevë, nga Partia Demokratike e Kosovës, duke shqyer dhe keqpërdorur fotot e kandidatëve tanë: znj. Fitore Pacolli dhe znj. Fjolla Ujkani me çka konsiderojmë se ka nxitur urrejtje ndaj subjekteve në fjalë dhe Lëvizjes Vetëvendosje!



Secilës ankesë i kishte bashkangjitur foto dhe linkat përkatës të cilët janë në shkresat e lëndës.

Se të përmendurit janë mbështetës dhe simpatizant i PDK-së, parashtruesi i ankesë e ka dëshuar me provat bashkëngjitura, si fotografi dhe link, ku dëshmohet përdorimi i gjuhës që nxitë, provokon akt të dhunës apo urrejtjes, në kundërshtim dhe në të cilën faktohet si mbështetës. Si dëshmi ka bashkangjitur provaku qartazi shihet veprimi mbështetësive simpatizantëve të subjekti politik PDK kanë shkelur dispozitat e nenit 34. paragrafi 1, pika 1.11 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë.

Në përgjigjen në ankesa të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës theksohet se, para se të trajtojmë meritat e ankesës, e shohim si të rëndësishme për të shqyrtuar çështjen e afatshmërisë së ankesës, pasi që siç mund të vërehet, ankuesi nuk i ka bashkëngjitur si dëshmi asnjë provë me të cilën argumentohet koha në të cilën ka ndodhur shkelja e pretenduar, pasi që në vështrim të provës së bashkëngjitur, dëshmohet vetëm që postimi të jetë shpërndara para disa orësh, mirëpo nuk mund të vërtetohet koha se kur është bërë Screenshoot, andaj si i tillë është e pamundur që të vërtetohet se në cilën kohë ka ndodhur shkelja e pretenduar në ankesë. Gjithsesi, edhe po të konsiderohet i mirëqenë fakti që ankuesi ka parashtruar ankesën në afat, vlerësojmë se ankesat si të tilla janë të pabazuara për arsyet si në vijim: PDK në asnjë mënyrë nuk e konteston faktin se veprimet e personave të cilët janë objekt i kësaj ankesë përbëjnë përdorim të gjuhës që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër tjerë, për të cilat vlerësojmë se padyshim përbëjnë veprime të ndaluara, por konsiderojmë se ankuesi nuk ka arritur që të argumentoi përgjegjësinë subjektive ndaj subjektit politik PDK, pasi që siç do të vërej ankuesi me asnjë provë nuk ka arritur që të bëj ndërlidhjen e veprimeve të personave të përmendur në ankesë, me përgjegjësinë e subjektit politik PDK, mirëpo është mjaftuar vetëm me pretendimin se të njëjtit janë mbështetës dhe aktivistë të PDK-së. respektivisht nuk ka argumentuar që të njëjtit të jenë pjesë e strukturave të Partisë Demokratike të Kosovës, apo ndonjë lidhje afërsie me këtë subjekt politik.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimt dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-03 1, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ankesat e evidentuara me numrat si ne vijimin: Anr.301/2025, të datës 01.02.2025, Anr.308, Anr.309, Anr.3 10 Anr.31 5/2025, Anr.32 1 /2025, dhe 02.02.2025., janë bashkuar dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjë e




përbashkët A.nr.301/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga subjekti i njëjtë politik LVV kundër subjektit të njëjtë politik PDK, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave. PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesat gjeti se: Ankesat janë të bazuara

Paneli, pas shikimit të shkresave të lëndës të ofruara si provë materiale, ka gjetur se mbështetësit dhe simpatizant të subjektit politik PDK, kanë vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, se gjuha e përdorur si më lartë nga mbështetësit dhe simpatizuesit e PDK-së është gjuhë denigruese dhe urrejtëse në raport me subjektin politik LVV. Sipas Panelit, përmbajtja e deklarimeve të tilla konsiderohen si gjuhë nxitëse dhe urrejtëse kundrejt subjektit politik LVV, dhe se kjo paraqet shkelje të rregullave zgjedhore në Kosovë, nga se deklaratimet e tilla në kohë të fushatës zgjedhore, kanë për qëllim të krijojnë polarizim të elektoratit, të krijojnë atmosferë tensioni ose të nxisë ndjenja të urrejtjes dhe të përçarjes, të acaroj rivalitetin politik. Paneli vlerëson se partitë dhe kandidatët si dhe mbështetësit dhe simpatizuesit e tyre janë të detyruar të respektojnë etikën zgjedhore dhe të shmangin veprime apo deklarime që mund të sjellin pasiguri, destabilitet apo të përkeqësojnë atmosferën politike në përgjithësi, njëkohësisht janë të obliguar të respektojnë dinjitetin dhe integritetin e të tjerëve. Përdorimi i gjuhës së tillë mund të dëmtojë procesin demokratik dhe të rrisë tensionet në vend. Kjo është një shkelje e rregullave që kërkojnë një fushatë paqësore, të ndershme dhe të drejtpërdrejtë.

Andaj Paneli gjeti se gjuha e përdorur është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët dhe se përdorimi i një gjuhe të tillë është në kundërshtim me nenin 34 pika 1.11), e LZP-së, me të cilën përcaktohet: "Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që bërja e ndonjëres si në vijim: nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë" edhe vendosi si në dispozitivin e vendimit të atakuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar në ligj qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, lidhur me dënimin e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës



zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09.02.2025. Vendimi i PZAP është i drejtë i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Nga kjo rezulton se në mënyrë të sigurt është vërtetuar shkelja e Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatet, e paraparë në nenin 34, 1.11, të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe nenit 24, pika 9.1 të Rregullores 01/2024 Për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës. Meqenëse ankuesi në ankesën e paraqitur nuk i është referuar shkeljeve konkrete të dispozitave të procedurës ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, por vetëm çështjeve që kanë të bëjnë me gjendjen faktike dhe lartësinë e gjobës së shqiptuar, Gjykata Supreme është kufizuar vetëm në trajtimin e këtyre pretendimeve ankimore.

Si rrjedhojë, objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme ishin pretendimet ankimore të subjektit politik të lartpërmendur, përkitazi me konstatimin jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, ashtu si thekson parashtruesi i ankesës, mirëpo këto pretendime dhe të tjerat në këtë drejtim nga kolegji i kësaj gjykate refuzohen si të pabazuara dhe jo të qëndrueshme. Kjo për faktin se PZAP, vendimin e atakuar e bazon në prova konkrete, të qarta dhe ekzistuese, siç është fotografia e ofruar si provë materiale, e cila janë publikuar në rrjetet social të mbështetësve të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, përkatësisht janë mbështetës së këtij subjekti. Gjykata Supreme e Kosovës gjeti se përmes fotografive dhe linkave dëshmohet qartazi se eksponentet që përdorin gjuhë të pa përshtatshme janë mbështetës të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe kjo u dëshmuar përmes fotove, teksteve apo edhe shenjave dalluese të subjektit politik. Prandaj pretendimi në ankesë se përdoruesit e gjuhës së pa përshtatshme nuk lidhen me subjektin politik, u refuzua si i pa bazuar

Nga kjo rrjedh se mbështetësit e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës PDK, me qëllim të etiketimit të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje dhe promovimit të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, ka nxitur urrejtje ndaj subjektit politik LVV, në atë mënyrë që përmes rrjetit social ka publikuar, përkatësisht shpërndarjen në faqen e tyre të rrjetit social video, në të cilët është bërë linqimi dhe etiketimi i eksponentëve më të lartë të LVV-së si bashkëpunëtor të serbëve. Nga kjo rezulton i drejtë dhe i ligjshëm konstatimi i PZAP-it, se me këto veprime është shkelur Kodi e Mirësjelljes dhe në veçanti neni 34. 1.11, i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, ku parashihet se *"1. Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të*



dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë".


Rrjedhimisht edhe gjoba e shqiptuar është e drejtë dhe në përputhje me praktikë e deritashme për gjashtë shkelje të ndryshme. Kjo për faktin se PZAP-i, me rastin e shqiptimit të gjobës së lartpërmendur, ka marr parasysh një mori rrethanash të precizuara më afër në arsyetimin e vendimit të tij, dhe se lartësia e gjobës e paraparë për një shkelje të tillë sipas nenit 120 paragrafi 1 pika 3, të Ligjit për zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës nr.08-228, është deri në 50.000 €. Në lidhje me këtë, Gjykata Supreme vlerëson se gjoba e shqiptuar këtij subjekti politik në lartësi prej 16,000.00 €, është e drejtë dhe e ligjshme, edhe për faktin se shkeljet e Kodit të Mirësjelljes nga ky subjekt janë prvuuar disa herë tjetër, prandaj me këtë gjobë vlerësohet se do të arrihet qëllimi ligjor i tij, përkatësisht jo vetëm ndëshkimi i shkelësve të dispozitave të Kodit të Mirësjelljes të Subjektit Politik, Mbështetësve dhe Kandidatëve të tyre, por edhe korrektimi i shkeljeve të ndryshme zgjedhore dhe sigurimi i mbarëvajtjes së këtyre dhe zgjedhjeve, si dhe ndikimi edhe në subjektet e tjera politike që garojnë në zgjedhje, që me përpikëri të zbatojnë dispozitat e Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Kodin e Mirësjelljes. Në anën tjetër, rezulton se PZAP-i, me rastin e shqiptimit të gjobës, ka marr për bazë të gjitha rrethanat e përcaktuara në legjislacionin përkatës, përfshirë këtu shkallën dhe peshën e shkeljes dhe natyrën e shkeljes.

Nisur nga gjendja faktike e vërtetuar, kjo Gjykatë konstatoi se në këtë çështje juridike, gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe nuk është shkelur ligji në dëm të parashtruesit të ankesës, prandaj, pretendimet në ankesë lidhur shkeljen e Kodit dhe me gjobën e shqiptuar u refuzuan si të pa bazuara, sepse si të tilla nuk dëshmuuan se përmbushin shkaqet për të cilat mund të paraqitet ankesa që të prezantohen fakteve të reja nga pala e interesuar dhe, nuk u gjetën shkelje procedurale e as ndonjë gabim faktik i cili ndikon në të drejtat e palës apo ligjshmërinë e procedurës.

Nga arsyet e theksuara me lartë, e në kuptim të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11), neni 118 paragraf 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME – PRISHTINË

AA.nr.38/2025, datë 07.02.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Kryetari i kolegjit,
Beshir Islami
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDUJE

Pufëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS/ SUDSKI SAVET KOSOVA/ KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

SEKRETARIATI I KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

SUPREME E KOSOVËS

Sheji i shkresës
Oznaka spisa:

AA-38/2025

LETËDËRGESE PËR DORËZIM PERSONAL DOSTAVNIKA ZA LICNO DOSTAVLANJE

PZAP - PRISHTINE

si marrësi, I cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në ku është dashtë të bëhet dorëzimi I sa pas lënjes së lajmërimit m që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: nadhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërtesës, fqjut, it që punon po n'atë vend me marrësin.

to primilac, koji pri prvom pokusajo dostave nije zatecen na mestu ostavljanja ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obavestjenja ostavljanja bude u odredjeno vreme u svom stanu radnom mestu, e izvršena; odraslom clanu domacin. Primaoca nastojniku zgrace licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

asi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e , shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ë derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

to primilac odnosno clan njenog domacinstva odbio prijem, pismo ljeno u stanu - radnom mestu primaoca (pribieno na vratima osno prostorije gde primilac zaposlen)

_____ 201 _____ në ora _____
u _____ cas.

refuzimit të marrjes _____
dbijanja prijmea _____

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljača

Emri i shkresës që dorëzohet:
Naslov pisma koja se dostavlja:

AKI GYKIM
07.02.2025

Numri i shtojcave: _____
broj priloga _____ 2

Vërtetoi se mora shkresën e lartpërmendur
më (me fjalë)
Povrdujemo prijem gorenavegenog pisma
(i slovima)

Ata u oti 10.02.2025

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Potpis primioča ili lica koje je
pismeno primilo u zamenu)

Oru
12.02

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljača

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesi, duke shënuar shkakun pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet. Atko je primilac nepismen ili nije u stanju da se potpiše, potpisuje ga dostavljač, napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.